

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika MonoTop<sup>®</sup>-112 MultiUse Repair

LLAÇ PËR RIPARIMIN E BETONIT



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MonoTop<sup>®</sup>-112 MultiUse Repair është një llaç prej 1 përbërësi, gati për përdorim dhe tiksotropik, me bazë lidhësi (binder) çimentoje dhe agregate të përzgjedhura që përmban mikrofibra sintetike për riparimin e betonit.

### PËRDORIMET

- Restaurim dhe riparim i elementeve prej betoni (kolona, skaje ballkonesh)
- Rinxjerrje në sipërfaqe të zonave të dëmtuara mbi sipërfaqe vertikale dhe horizontale betoni
- Riprofilizim i sipërfaqeve prej betoni

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim i thjeshtë, edhe horizontalisht
- Ndërkapje e mirë mbi shumicën e materialeve të ndërtimit si betoni, guri, tullat, çeliku
- Përzierje e lehtë, thjeshtë shtoni ujë
- Veti mekanike të mira

### MIRATIME / STANDARDE

Llaç riparues për riparime strukturore dhe jostrukturore të betonit sipas EN 1504-3:2005, Deklaratë Performance 69245044, certifikuar nga organi i njoftuar i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë 0546, certifikatë pajtueshmërie të kontrollit të prodhimit në fabrikë 18774 dhe mbart markën CE.

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

|  |  |
|--|--|
| Baza kimike                            | Binder çimentoje dhe agregate të përzgjedhura, mikrofibra sintetike dhe aditivë të posaçëm       |
| Ambalazhi                              | Qese alumini 5 kg në kuti kartoni që përmban 4 copë  |
| Paraqitja / Ngjyra                     | Pluhur gri   |
| Jetëgjatësia                           | 18 muaj  |
| Kushtet e magazinimit                  | Të ruhet në ambalazhin e padëmtuar, origjinal dhe të mbyllur në kushte të thata dhe të freskëta. |
| Dendësia                               | Dendësia e llaçit të freskët: ~2.05 kg/l   |
| Përmasa maksimale e kokrrizës          | D <sub>max</sub> : 2.5 mm  |
| Përmbajtja në jone të tretshme kloruri | ≤ 0.05% (EN 1015-17)   |

### TË DHËNA TEKNIKE

|                                     |                       |            |
|-------------------------------------|-----------------------|------------|
| Rezistenca ndaj ngjeshjes           | ~50 MPa pas 28 ditësh | (EN 12190) |
| Moduli i elasticitetit në ngjeshje  | ~15.7 GPa             | (EN 13412) |
| Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje | ~2 MPa                | (EN 1542)  |

|                                   |   |              |
|-----------------------------------|---|--------------|
| <b>Kompatibiliteti termik</b>     | ~2 MPa (Pjesa 1- Ngrirje-Shkrirje)          | (EN 13687-1) |
| <b>Reagimi ndaj zjarrit</b>       | Euroclass A1                                | (EN 13501-1) |
| <b>Absorbueshmëria kapilare</b>   | ≤ 0.5 kg.m <sup>-2</sup> .h <sup>-0.5</sup> | (EN 13057)   |
| <b>Rezistenca ndaj karbonimit</b> | dk ≤ beton kontrolli (MC (0.45))            | (EN 13295)   |

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

|                                  |   |
|----------------------------------|---|
| <b>Raporti i përzierjes</b>      | 0.7–0.84 litra uji për 5 kg pluhuri.<br>14 % – 16 % litra uji për peshë pluhuri.  |
| <b>Konsumimi</b>                 | Varet nga ashpërsia e nënshtresës dhe trashësia e shtresës së aplikuar.<br>Sa për udhëzim, ~1,8 kg/m <sup>2</sup> për cm trashësie për m <sup>2</sup> . |
| <b>Rendimenti</b>                | 5 kg pluhuri prodhon afërsisht 2.83 litra llaç.   |
| <b>Trashësia e shtresës</b>      | 5 mm min. / 25 mm max.<br><br>Për trashësi më të mëdha thjesht shtoni përsipër më shumë shtresa sapo e mëparshmeja të jetë ngurtësuar.                  |
| <b>Temperatura e mjedisit</b>    | +5 °C minimum / +35 °C maximum  |
| <b>Temperatura e nënshtresës</b> | +5 °C minimum / +35 °C maximum  |
| <b>Koha e punueshmërisë</b>      | ~60 minuta në +23 °C  |

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Betoni:

Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme dhe pa pluhur, pislleqe, materiale të shkrifëta, kontaminime sipërfaqësore si vaj ose graso dhe kore çimentoje.

Armatura:

Sipërfaqja e çelikut nuk duhet të ketë ndryshk, vaj, graso, pluhur dhe materiale të tjera të shkrifëta të cilat mund të reduktojnë ngjitjen ose të shkaktojnë korrodin.

### PËRZIERJA

Sika MonoTop®-112 MultiUse Repair mund të përzihet me një përzierës manual elektrik. Në sasi të vogël, produkti mund të përzihet edhe manualisht. Hidhni sasinë e rekomanduar të ujit në një konteiner të përshtatshëm për përzierje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni pluhurin tek uji dhe përzieni plotësisht për të paktën 3 minuta. Hidhni ujë shtesë gjatë kësaj kohe nëse nevojitet deri në sasinë maksimale të specifikuar dhe adaptojeni sipas konsistencës së kërkuar.

### APLIKIMI

Lagni paraprakisht nënshtresën e përgatitur. Ruani sipërfaqen të lagësht dhe mos e lejoni të thahet. Përpara aplikimit, hiqni ujin e tepruar, p.sh. me një sfungjer të pastër. Sipërfaqja duhet të ketë pamje të errët mat pa shkëlqim dhe poret sipërfaqësore nuk duhet të përmbajnë ujë.

Për punime të vogla restaurimi si riparimi i strukturave prej betoni, dekorimi i ballkoneve, anët e shtyllave Sika MonoTop®-112 MultiUse Repair mund të aplikohet me

mallë. Fillimisht shtroni një shtresë të parë duke hedhur me forcë llaçin riparues mbi nënshtresë për të formuar një shtresë të hollë. Ndërtojini shtresat nga fundi në krye duke ngjeshur llaçin mirë mbi zonën që do të bëhet riparimi. Sipërfaqja mund të finirohet me një mallë me sfungjer, disa minuta pas aplikimit, sapo llaçi ka filluar të ngurtësohet.

### METODA E MATURIMIT

Mbroni menjëherë llaçin e freskët nga tharja e parakoshme duke përdorur metodë të përshtatshme tharjeje, p.sh. përbërës trajtimi, membranë gjeotekstile lagështie, fletë polietileni, etj.

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

### KUFIZIME

- Shmangni aplikimin në diell të drejtpërdrejtë dhe/ose erë të fortë.
- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar.
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresë të qëndrueshme dhe të përgatitur.
- Mos hidhni ujë shtesë gjatë finiturës së sipërfaqes pasi kjo gjë shkakton çngjyrosje dhe plasaritje.
- Mbroni materialin e freskët të aplikuar nga ngrirja.
- Mos shtoni tek produkti asgjë që nuk specifikohet në këtë skedë teknike.

### BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova

laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositetë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sika MonoTop®-112 MultiUse Repair  
Mars 2019, Botimi 01.01  
020302040030000144

SikaMonoTop-112MultiUseRepair-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf